



## One Albania SHA

Adress: "Muhedin Llagami" St., "Square 21" Complex, Tirana, Albania

Phone: +355 42275232 | E-mail: contactus@one.al

Certified: ISO 9001 | ISO 45001 | ISO 14001 | ISO 37001 | ISO 37301 | ISO 27001 | ISO 20000 | BS PAS 99 | ISO 31000 | NIPT: J61814094W

## KONTRATE PËR SHËRBIMIN ONE TV

*Lidhur nga dhe ndërmjet:*

**ONE Albania SH.A** person Juridik, me numer NIPT J61814094W, , perfaqesuar ne kete kontrate nga Z. \_\_\_\_\_, me adresë Rruga "Muhedin Llagami",Kompleksi Square 21, Tirane, Shqiperi me poshtë i quajtur si **"One Albania"** dhe/ose **"Operatori"**

Dhe

Pajtimtari \_\_\_\_\_ (Emër Atësi Mbiemër) , mbajtes i dokumentit identifikues me nr. \_\_\_\_\_, me nr personal \_\_\_\_\_, lindur me, \_\_\_\_\_, ne \_\_\_\_\_ dhe banues në adresën \_\_\_\_\_ që më poshtë do të quhet **"PAJTIMTAR"**.

Të dy së bashkur referuar si "Palët" dhe individualisht si "Pala",

### 1. Objekti.

Objekti i kësaj kontrate është ofrimi i paketave per Shërbimin One TV të ONE Albania, sipas Aneksit 1 te kesaj kontrate, kundrejt pajtimit përkatësisht nga Pajtimtari sipas termave të kësaj Kontrate.

### 2. Afati.

Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga Palët dhe do t'i shtrijë efektet per një afat minimal, qe perkon me paketen e perzgjedhur ne Aneksin 1 bashkelidhur kesaj kontrate. Pas kalimit të këtij afati, kontrata do të jetë me afat të pacaktuar dhe Pajtimtari mund të perfundojë kontratën duke njoftuar me shkrim ONE Albania 30 ditë përpara përfundimit. Në cdo rast, pavarësisht paraqitjes së kërkesës kontrata do të konsiderohet e përfunduar në ditën e fundit të muajit.

### 3. Çmimi dhe pagesa.

- i. Çmimi i shërbimit dhe pagesa është në përputhje me përcaktimet e paketës dhe planit tarifor që zgjedh Pajtimtari ne Aneksin 1.
- ii. Per paketat me parapagim, pagesa per te gjithe periudhen kontraktore kryhet ne ditën e nënshkrimit te kontrates, ndersa per paketat me paspagim, pagesa do të kryhet brenda afatit të përcaktuar në faturën e emetuar nga ONE Albania.
- iii. Në rast vonese në pagese, ONE Albania do të aplikojë ndaj Pajtimtarit një kamatë vonesë në masën 0.5% të faturës mujore të papaguar, për çdo ditë vonesë në pagim nga afati i pagesës së përcaktuar në faturë.
- iv. Ne rast se Pajtimtari nuk kryen pagesen brenda afatit te percaktuar ne fature, ONE Albania do te marre masa kufizuese te ofrimit te sherbimeve objekt kontrate per Pajtimtarin.
- v. Kur Pajtimtari nuk përmbush detyrimet kontraktore për pagimin e shumave të faturuara brenda afatit kohor të përcaktuar në faturë, ONE Albania do t'i dërgojë Pajtimtarit një njoftim me shkrim ose SMS ose me një mjet të qëndrueshëm komunikimi në lidhje me masat kufizuese ose ndërprerjen e shërbimit/kontratës, duke vendosur afatin kohor prej jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për të përmbushur këto detyrime.
- vi. Me kalimin e afatit kohor 15 (pesëmbëdhjetë) ditor, ONE Albania ka të drejtë të kufizojë ose të ndërpresë plotësisht shërbimin.
- vii. Në rast të moskryerjes së pagesave edhe pas kufizimit ose ndërprerjes së shërbimit, ONE Albania rezervon të drejtën të ndërpresë përfundimisht shërbimin objekt i kesaj kontrate sipas njoftimit të dërguar.
- viii. Pavarësisht kufizimeve të parashikuara më lart, Operatori ka të drejtë të gjenerojë faturë për shërbimet e ofruara gjatë muajit të mëparshëm/vijues sipas planit tarifor të pajtimtarit.

### 4. Të drejtat dhe detyrimet e Palëve.

#### 4.1 Pajtimtari:

- i. Pajtimtari do të kryejë në afat pagesat ndaj ONE Albania për shërbimin objekt i kësaj kontrate.
- ii. Pajtimtari detyrohet të përdorë shërbimin vetëm nëpërmjet rrjetit ONE Albania dhe dekoderin (aparatin transmetues) në rast se ky i fundit është i aplikueshem varësisht teknologjisë, vetëm sipas udhëzimeve të dhëna nga ONE Albania dhe përcaktimeve në manualin e përdorimit, dhe të mos kryejë asnjë lloj ndërhyrje që ndikon në shërbimin e ofruar. Dekoderi (nëse aplikohet) në çdo rast do të jepet në përdorim Pajtimtarit nga ONE Albania i shoqëruar me manualin e përdorimit përkatës dhe do të jetë me garanci, afati i së cilës do t'i bëhet me dije Pajtimtarit në momentin e vënies në dispozicion të tij.
- iii. Në rast se Dekoderi (nëse aplikohet), dëmtohet apo nuk funksionon në mënyrën e duhur, Pajtimtari duhet të njoftojë menjëherë ONE Albania nëpërmjet mënyrave të komunikimit të përcaktuara këtu. Në rast se konstatohet se dëmtimi apo mosfunksionimi ka ardhur për shkak të pajtimtarit, apo faktorëve të tjerë që nuk kanë të bëjnë me ONE Albania, pajtimtari do të jete vetë përgjegjës për zëvendësimin e aparatit apo riparimit të tij qoftë edhe të ndonjë pjese përbërëse.
- iv. Pajtimtari merr përsiper të ruajë dhe mirëmbajë aparatit transmetues apo cdo aparat te dhene nga ONE Albania ne kuader te kesaj kontrate (nëse aplikohet), si dhe të mos kryejë asnjë lloj riparimi apo ndërhyrjeje të paautorizuar në aparat. Në rast të përfundimit të Kontratës, Pajtimtari duhet ta kthejë aparatit/aparatet (nëse aplikohet) brenda 5 ditëve nga përfundimi dhe/ose të sigurojë akese të Operatorit për zberthimin (çmontimin) perkatesisht. Në të kundërt Pajtimtari është përgjegjës të paguajë vlerën e aparatit/aparateve te dhenen ne perdorim nga ONE Albania.



## One Albania SHA

Address: "Muhedin Llagami" St., "Square 21" Complex, Tirana, Albania

Phone: +355 42275232 | E-mail: contactus@one.al

Certified: ISO 9001 | ISO 45001 | ISO 14001 | ISO 37001 | ISO 37301 | ISO 27001 | ISO 20000 | BS PAS 99 | ISO 31000 | NIPT: J61814094W

- v. Pajtimtari njih dhe pranon se objekt i kësaj kontrate, do të përfitohet sipas kushteve dhe parametrave të ONE Albania.
- vi. Pajtimtari nuk do të përdorë shërbimin dhe produktet e lidhura me të, të ofruar nga ONE Albania, për qëllime rishitje apo mënyra të tjera fitimi dhe as nuk do ta transferojë atë në palë te treta, me përjashtim të rasteve kur ky veprim autorizohet nga ONE Albania.

### 4.2 ONE Albania

- i. ONE Albania merr përsipër ofrimin e shërbimit në mënyrë të pandërprerë për sa kohë që kjo është e mundur teknikisht për zonën e mbulimit. Në çdo rast, shërbimet mund të ndërpriten për shkak të mirëmbajtjes periodike të sistemit, përmirësimeve/përditësimeve të këtij të fundit. Në çdo rast, Pajtimtari do të njoftohet për ndërprerjet dhe arsyen përkatëse.
- ii. ONE Albania merr përsipër shqyrtimin e kërkesave apo ankesave të Pajtimtarit që kanë të bëjnë me shërbimin/produktin e ofruar, në një kohë të përshtatshme.
- iii. ONE Albania do të sigurojë asistencë të nevojshme teknike përgjatë gjithë vlefshmërisë së kësaj kontrate, por në asnjë rast nuk do të jetë përgjegjës për mosfunksionim apo dëmtim të rrjetit si rezultat i përdorimit nga Pajtimtari jo në përputhje me instruksionet e dhëna, si rezultat i ndërhyrjeve të paautorizuara të të tretëve, nga luhatjet e tensionit, apo faktorë të tjerë të jashtëm si rrufetë etj.
- iv. ONE Albania në çdo kohë ka të drejtë të ndryshojë përmbytjen dhe /ose numrin e kanaleve që transmetohen dhe Pajtimtari nuk ka asnjë pretendim lidhur me këtë.
- v. ONE Albania do të bëjë aktivizimin e shërbimit brenda 3 ditëve punë nga nënshkrimi i kontratës nga Palët.
- vi. ONE Albania ka të drejtë të pezullojë/perfundojë ofrimin e shërbimit /kontraten për shkaqe që lidhen me ofrimin e shërbimit të aksesit në internet të ONE Albania.

### 5. Penalitete dhe përfundimi i kontratës.

- i. Në çdo rast, kur Pajtimtari nuk ka përmbytur në afat detyrimet ndaj ONE Albania, ose për shkelje të tjera të kontratës, ONE Albania ka të drejtë të ndërmarrë masa të cilat konsistojnë në kufizim shërbimi, ndërprerje shërbimi apo përfundim të kontratës.
- ii. Në rast se Pajtimtari e përdor Shërbimin e ofruar nga ONE Albania për qëllime rishitje apo mënyra të tjera fitimi, apo e transferon atë në palë të treta pa miratim me shkrim të ONE Albania ky i fundit do të ndërpresë në mënyrë të menjëherëshme ofrimin e shërbimit dhe nuk do të ketë asnjë përgjegjësi lidhur me këtë. Në çdo rast, kjo ndërprerje do të konsiderohet nga ONE Albania si përfundim i kontratës përpara afatit nga Pajtimtari.
- iii. Në rast përfundimi të ndonjeres prej paketave të perzgjedhura përpara afatit fillestar të percaktuar në Aneksin 1 të kësaj kontrate, pajtimtari do të jetë subjekt penalitetit sipas percaktimeve të Aneksit 1 të kësaj kontrate.

### 6. Ndryshimet në kontratë.

ONE Albania në çdo rast, duke njoftuar në një kohë dhe mënyrë të përshtatshme Pajtimtarin, rezervon të drejtën e ndryshimit të kushteve të kësaj kontrate, për arsye që lidhen me nevojat e tij, për strategji biznesi apo marketingu si dhe si rezultat i ndryshimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

### 7. Konfidencialiteti.

Palët bien dakort se do të mbajnë konfidenciale kushtet dhe termat e kësaj kontrate dhe anekseve të saj, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

### 8. Forcat Madhore.

ONE Albania nuk do të jetë përgjegjës për mospërmbyturje të detyrimeve që rrjedhin nga kjo kontratë kur kjo mospërmbyturje ka ardhur si rezultat i Forcave Madhore, ndërprerjes së shërbimit nga palë të treta apo ndërhyrjeve në rrjet nga të tretët.

Kjo kontratë hartohet në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

OPERATORI

\_\_\_\_\_  
[Emër, Mbiemër]

\_\_\_\_\_  
[Nënshkrimi]

PAJTIMTARI

\_\_\_\_\_  
[Emër, Mbiemër]

\_\_\_\_\_  
[Nënshkrimi]